REPUBLIKAESHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.8366prot. Himarë, më 05.11. 2026

VENDIM

NR.60 DATË 30.10.2026

PËR

"MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRBASHKIAKE PËR BASHKËPUNIMIN PËR PUNËSIM NDËRMJET BASHKISË HIMARË DHE ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË EMIGRACIONIT (IOM)"

Në mbështetje të Kushtetutës, të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.5, neni 14 pika 1, 2 dhe 3, nenit 22, pika 1dhe 2, nenit 28, nenit 29 pika 1, nenit 54 dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, nenit 119 të ligjit nr. 44/2015 tw "Kodit të procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", Bashkia Himarë, me propozim të kryetarit të bashkisë dhe me qëllim realizimin e projekteve që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe forcimin e kapaciteteve vendore, Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 30.10.2026, miratoi me 14 (katërmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 2 (dy) abstenim dhe si më poshtë;

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes ndërbashkiake për bashkëpunimin për punësim ndërmjet Bashkisë Himarë dhe Organizatës ndërkombëtare të emigracionit (IOM) me seli në Tiranë.
2. Dhënien e miratimit Kryetarit të Bashkisë Himarë për nënshkrimin e marrëveshjes ndërbashkiake për bashkëpunimin për punësim ndërmjet Bashkisë Himarë dhe Organizatës ndërkombëtare të emigracionit (IOM) me seli në Tiranë.
3. Ngarkohet drejtoria e integrimit europian dhe projekteve me donatorët për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas legjislacionit përkatës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HIMARË

KRYETARI
Dhimitër Kapaj

MARRËVESHJE NDËRBASHKIAKE (*TIP*)
PËR
BASHKËPUNIMIN PËR PUNËSIM

lidhur ndërmjet

Institucioneve të nivelit të qeverisjes vendore dhe qendrore, institucioneve të Formimit Profesional, përfaqësues të sekorit privat:

- *Duke qenë se reduktimi i migrimit të jashtëm të punëtorëve të kualifikuar, zbutja e rreziqeve të migrimit të parregullt dhe lehtësimi i lëvizshmërisë së brendshme të punës është një sfidë që prek qeverisjen qëndrore dhe vendore, që kërkon angazhim të koordinuar dhe të qëndrueshëm të të gjithë aktorëve dhe faktorëve të komunitetit dhe shoqërisë;*
- *Duke qenë se vetëqeverisja vendore përballet me sfida të konsiderueshme për hartimin dhe zbatimin e politikave për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të territoreve dhe komuniteteve vendore, që synojnë rritjen e mundësisë për punësime dhe mirëqënies sociale dhe ekonomike të qytetarëve;*
- *Duke qenë të vetëdijshëm se përmbushja e objektivave të vetëqeverisjes vendore dhe rritja e mirëqënies sociale dhe ekonomike të komuniteteve vendore kërkon angazhim të koordinuar dhe të qëndrueshëm të të gjithë aktorëve dhe faktorëve të komunitetit dhe shoqërisë;*
- *Duke njohur se procesi i decentralizimit të funksioneve drejt bashkive, si dhe rritja e kërkesave nga komunitetet vendore për shërbime më efikase, gjithëpërfshirëse dhe të integruara, e bëjnë të domosdoshëm krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm të partneritetit për koordinim dhe bashkërendim të ndërjelltë midis bashkive dhe aktorëve/subjekteve të tjerë lokal dhe kombëtar me qëllim mbledhjen dhe shkëmbimin e informacionit mbi mundësitë e punësimit, rritjen e zhvillimit të aftësive, kryerjen e analizave të trendit të tregut të punës, lehtësimin e lëvizshmërisë së punëkërkuesve nga bashkitë me shkallë të lartë të papunësisë te ato që ofrojnë më shumë mundësi punësimi, dhe sigurimin e mbrojtjes së migrantëve të brendshëm në përputhje me legjislacionin kombëtar;*
- *Duke theksuar se njësitë e vetëqeverisjes vendore janë aktorë thelbësorë në nxitjen dhe mbështetjen për rrjetizimin dhe ndërgjegjësimin e subjekteve ekonomike mbi efektet që vijnë në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe veçanërisht ato për punësimin, migracionin e brendshëm dhe zhvillimin rajonal dhe kohezionin social;*

Palët bien dakord të lidhin këtë marrëveshje sipas kushteve dhe përcaktimeve të mëposhtme:

Neni 1
Baza ligjore

1. Kjo marrëveshje lidhet në përputhje me:

- nenet 14, 24, 28 29/1 të Ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ndryshuar, Ligjin Nr. 38/2019, datë 20.06.2019.
    - Funksionet e bashkive në fushën e zhvillimit ekonomik vendor (neni 28).

- Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë " ndryshuar;
- Ligjin nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit";
- Ligjin nr. 146/2015, datë 17.12.2015 "Për punëkërkuesit";
- Ligji nr. 15/2017, datë 16.02.2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë";
- Ligjin nr. 9634, datë 30.10.2006 "Për Inspektimin e Punës në Shqipëri" i ndryshuar;
- Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" ndryshuar nga ligji nr.124/2020.
- VKM Nr. 271, dt. 02.05.2024 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe të planit të saj të veprimit 2024–2026";
- VKM Nr. 173, datë 24.03.2023, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2023-2030, Planit të Veprimit për zbatimin e saj dhe Planit të Zbatimit të Garancisë për Rininë";

Neni 2
Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjë është krijimi dhe institucionalizimi i një mekanizimi bashkëpunimi dhe bashkërendimi me përfitim të ndërjesllte midis bashkive palë në këtë Marrëveshje dhe institucioneve të tjera qendrore dhe aktorëve lokal për të lehtësuar dhe rritur mundësitë e punësimit nëpërmjet mobilitetit të brendshëm të punës, veçanërisht për gratë dhe vajzat, të rinjtë dhe grupet e tjera të vulnerabël, dhe kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe social të bashkive. Veprimet e ndërmarra në zbatim të kësaj marrëveshjeje nuk cenojnë kompetencat ligjore të institucioneve qendrore përgjegjëse për punësimin, formimin profesional dhe migracionin, por synojnë mbështetjen dhe koordinimin ndërinstitucional.

Neni 3
Objekti i Marrëveshjes

Bashkitë, palë në këtë Marrëveshje bien dakord dhe angazhohen të bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën dhe veprimtarinë e tyre të ndërsjelltë me qëllim që:

a) Të promovojnë përputhjen efektive të vendeve të lira të punës dhe punëkërkuesve te papune midis bashkive të origjinës dhe bashkive pritëse/të destinacionit nëpërmjet organizimit të panaireve të përbashkëta të punës, që janë dakortësuar në Komitetin Koordinues për Punësim, por jo më pak se një panair në vit.

b) Të lehtësojnë punësimin e punëtorëve nga bashkitë e origjinës në bashkitë pritëse nëpërmjet krijimit të strukturave apo njësive përkatëse pranë bashkisë që ofrojnë shërbime të integruara dhe standartizuara për grupe të ndryshme, sipas rastit;

c) Të garantojnë akses të barabartë në shërbime pa asnjë formë diskriminimi, dhe kontribojë në zvogëlimin e hendekut të punësimit midis burrave dhe grave, duke mbështetur punësimin e të rinjve, grave dhe vajzave dhe përfshirjen për grupet e vulnerabël;

d) Të mbështesë bizneset duke lehtësuar aksesin në informacion apo të dhëna mbi fuqi punëtore të kualifikuar nëpërmjet zhvillimit të takimeve periodike;

e) Të forcojnë bashkëpunimin dhe partneritetin ndërmjet bashkive palë në në këtë Marrëveshje dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), shoqatave të punëdhënësve dhe sektorit privat për të promovuar përfitime reciproke ekonomike dhe sociale;

f) Të zbusë rrjedhjen e punëtorëve të kualifikuar drejtë migrimit të jashtëm duke nxitur mundësitë e punësimit lokal, nëpërmjet ofrimit të ndihmës me informacion.

Neni 4
Detyrimet dhe të Drejtat e Palëve

1. Në përmbushje të kësaj Marrëveshje, **secila Palë** ka këto të drejta dhe detyrime:

a. Miraton aktet e nevojshme, duke përfshirë ato financiare, për krijimin e kushteve për realizimin e parashikimeve të kësaj Marrëveshje sipas legjislacionit në fuqi;
b. Kontribuon nëpërmjet anëtarëve në Komitetin Koordinues për Punësim si dhe në strukturat e tjera të përcaktuara në këtë Marrëveshje me qëllim realizimin e objektit të kësaj Marrëveshje.
c. Vendos në dispozicion të bashkive të tjera apo Komitetit Koordinues për Punësim planin vendor për diasporën të miratuar apo çdo dokument tjetër të nevojshëm me qëllim harmonizimin e qasjeve për reduktimi i migrimit të jashtëm të punëtorëve të kualifikuar, zbutjen e rreziqeve të migrimit të parregullt dhe lehtësimin e lëvizshmërisë së brendshme të punës si dhe ofron asistencë teknike për bashkitë e tjera në hartimin e akteve të nevojshme për ushtrimin e përgjegjësive në përputhje me legjislacionin në fuqi.
d. mbledh dhe përpunon informacion nga Drejtoritë/Zyrat Vendore të AKPA në lidhje me vendet e disponueshme të punës dhe punëkërkuesit e papunë, në baza dy javore, si dhe informacion në lidhje me legjislacionin e punësimit, politikat e pagave dhe çdo program kombëtar që mund të ndihmojne iniciativat lokale sipas nevojës. Informacioni përpunohet dhe përfshihet në formularin tip pjesë e kësaj Marrëveshje (Shtojca 5).

e. mbledh dhe përpunon informacion mbi nevojat dhe aftësitë e fuqisë punëtore të bizneseve, sindikatat, dhomat e tregtisë që zhvillojnë aktivitet në territorin e bashkive e tyre dhe kryen analiza të vazhdueshme të tendencave të tregut për të identifikuar sektorët kryesore që përjetojnë rritje dhe sektorët që përballen me mungesë aftësish.

f. krijon strukturë apo njësi të posaçme dhe/apo delegojne funksionet tek një punonjës ekzistues për punësim dhe mbështetjen e migrantëve të brendshëm dhe familjeve, që përbëhet nga të paktën 1 përfaqësues që mbulon çështjet për diasporën dhe migracionin, 1 përfaqësues që mbulon çështjet e përfshirjes sociale dhe 1 përfaqësues që mbulon çështje të zhvillimit ekonomik, që ofrojnë këto shërbime:
   (i) Mbështetje për banim dhe integrim social;
   (ii) Programe të dedikuara për orientim shoqëror dhe integrim në komunitet.
   (iii) Informacion dhe mbështetje financiare për strehim përmes programeve bashkiake për punësim sezonal dhe afatgjatë.
   (iv) Mbështetje në transferimin e brendshëm të familjes nëpërmjet ndihmës për regjistrimin e fëmijëve në sistemin arsimor dhe në sistemin parashkollor (kopsht).
   (v) Mbështetje për regjistrimin e banimit të përhershëm.
   (vi) Informacion për Programet e Praktikave Profesionale të ofruara nga bizneset që operojnë në territorin e bashkisë.

Për ofrimin e këtyre shërbimeve struktura apo njësia koordinohet në mënyrë të vazhdueshme me përfaqësues nga drejtoritë rajonale ose sektorët e zyrave vendore të punësimit të AKPA, përfaqësues të Inspektoratit Rajonal/Vendor të Punës si dhe aktorë të tjerë sipas rastit.

f. Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm në kuadër të realizimit të qëllimit të kësaj Marrëveshje, duke përfshirë marrjen e masave të nevojshme mbulimin e efekteve financiare si dhe ndërveprimin me ministritë e linjës apo institucione të tjera shtetërore apo private.

2. Bashkitë palë në këtë Marrëveshje angazhohen të plotësojnë angazhimet dhe detyrimet duke zbatuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe profesionale që garanton akses në shërbime të përshtatura (dedikuara), barazi në dhënien e shërbimit sipas parimit 'njeriu në qendër të mbështetjes', përputhshëri me legjislacionin në fuqi për të dhënat personale, si dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucionet qendrore dhe aktorët lokal.

Neni 5
Organizimi dhe Funksionimi i Komitetit Koordinues për Punësim

1. Palët bien dakord për krijimin e **një Komitet Koordinues për Punësim** që përbëhet nga përfaqësues nga secila bashki, palë në këtë Marrëveshjes, në nivel të lartë drejtues të caktuar nga Kryetari i Bashkisë[1].

2. Komiteti kryhesohet bazuar në një sistem rotacioni çdo 6 muaj, bazuar në numrin e popullisë në territor. Komiteti drejtohet 6 mujorin e parë nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje nga përfaqësuesi i bashkisë më të madhe me numër popullsie. Mbledhjet e Komitetit zhvillohen me prezencë fizike ose me mjetet elektronike të komunikimit.

[1] Për diskutim nëse do të jetë në nivel nënkryetari përfaqësimi

3. Komiteti mblidhet të paktën 4 herë në vit dhe sa herë është e nevojshme për të diskutuar dhe përcaktuar planin e aktiviteteve të rregulluara nga kjo Marrëveshje, si dhe çdo ndryshim që mund të jetë i nevojshëm.
4. Komiteti fton në mbledhje apo zhvillon takime me përfaqësues të drejtorive rajonale/apo sektorëve të zyrave vendore të punësimit të AKPA në nivel bashkie dhe përfaqësues të shoqatave lokale të biznesit, sindikatave dhe dhomave të tregtisë apo donatorëve të ndryshëm të listuara në Shtojcën I Lista e Institucioneve dhe Organizatave.
5. Në zbatim të këtij Marrëveshje, çdo palë cakton Koordinatorët përkatës në nivel teknik që angazhohen të shkëmbejnë informacion, monitorojnë dhe raportojnë mbi ecurinë, si dhe të informojnë titullarin e institucionit dhe Komitetin në lidhje me zbatimin e këtij Marrëveshje.
6. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke përfshirë formën e komunikimit elektronik. Palët njoftojnë reciprokisht në rast se ndryshohet Koordinatori i projektit. Komiteti miraton rregulla të brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e tij.

Neni 6
Kompetencat e Komitetit Koordinues për Punësim

1. Komiteti Koordinues për Punësim është përgjegjës për:
   a. mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj Marrëveshje.
   b. shërben si forum për ndjekjen e progresit të Marrëveshjes dhe sigurimin e shkëmbimit në kohë dhe të saktë të informacionit apo dokumenteve ndërmjet bashkive që lidhen me disponueshmërinë e fuqisë punëtore, informacionin e kontaktit dhe moshën, duke përfshirë aftësitë, kualifikimet dhe gatishmërinë për të punuar apo edhe të dhëna të tjera të nevojshme.
   c. identifikimin dhe adresimin e çështjeve të tilla si mospërputhjet e aftësive, barrierat e lëvizshmërisë së punës, dhe asistencë dhe mbrojtje për migrantët e brendshëm të punës.
   d. siguron që analiza e tregut të punës dhe parashikimet e kërkesës për punë të përfshihen në funksion të realizimit të kësaj Marrëveshje.
   e. miraton paketën e standartizuar të shërbimeve që ofrohen nga strukturat apo njësitë pranë bashkive për mbështetjen e migrantëve të brendshëm dhe familjeve.
   f. miraton plan pune/veprimi, si dhe kalendarin e aktiviteteve dhe eventeve të përbashkëta midis palëve në Marrëveshje dhe institucioneve të tjera shtetërore si dhe bizneseve si dhe sigurohet për organizimin dhe mbarëvajtjen e tyre. Në këtë aktivitet, Komitetit mund të mbështetet në asistencën e donatorëve të ndryshëm që zhvillojnë aktivitet në këtë fushë.
   g. bashkëpunon me institucione të tjera shtetërore apo biznesit, sindikatat, dhomat e tregtisë apo donatorë analiza të përbashkëta për të kuptuar ndryshimet e zhvillimeve sektoriale, disponueshmërinë dhe aftësitë e punëtorëve, sektorët në zhvillim dhe ndryshimet në kërkesat e fuqisë punëtore. Kjo analizë do të fokusohet në tendencat afatshkurtra dhe ato afatgjata dhe do të drejtojë zhvillimin e strategjive dhe iniciativave të Marrëveshjes.

h. organizon në bashkëpunim me institucione të tjera shtetërore apo biznesit, sindikatat, dhomat e tregtisë dhe donatorë panaire të përbashkëta pune, të paktën një herë në vit, me qëllim promovimin e:
   - mundësive të punës sezonale;
   - programet e praktikave;
   - programet e formimit professional;
   - zbatimin e qasje të barabartë në punë dhe zvogëlimin e hendekut gjinor të punësimit;
   - shkëmbimin e përvojave pozitive dhe rrjetëzimin për avancim në karrierë dhe shkëmbim njohurish.

i. Çdo përpunim dhe shkëmbim i të dhënave personale kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe vetëm për qëllimet e kësaj marrëveshjeje.

Neni 7
Efektet financiare të zbatimit të Marrëveshjes

1. Bashkitë palë në këtë Marrëveshje angazhohen të mbulojnë efektet financiare që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshje në përputhje me buxhetet e miratuara sipas legjislacionit në fuqi.
2. Shpenzimet për aktivitetet e përbashkëta miratohen paraprakisht nga Komiteti dhe mbulohen sipas një plani financiar të dakordësuar nga palët.

Neni 8
Monitorimi dhe Vlerësimi

1. Komiteti Koordinues për Punësim harton në Dhjetor të çdo viti kalendarik një raport mbi aktivitetin e zhvilluar, si dhe gjetjet, analiza të të dhënave të përftuara dhe sfidat e evidentuara.
2. Raporti i paraqitet të gjithë kryetarëve të bashkisë pjesë e kësaj Marrëveshje, Këshillit Bashkiak si dhe Prefektit të Qarkut përkatës.
3. Mosrealizimi i detyrimeve nga njëra palë nuk krijon përgjegjësi financiare për palët e tjera, por evidentohet në raportin vjetor të Komitetit.

Neni 9
Afati i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një kohëzgjatje 4 (katër) vjeçare nga momenti i hyrjes në fuqi të saj.
2. Marrëveshja mund të përfundojë nga secila palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim palës tjetër, të paktën 1 (një) muaj përpara.

Neni 10

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje që lind midis palëve lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet në radhë të parë nëpërmjet dialogut dhe mirëkuptimit të ndërsjellë.
2. Në rast se mosmarrëveshja nuk zgjidhet në këtë mënyrë, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 11

Hyrja në Fuqi

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi është nënshkruar rregullisht nga të gjitha palët dhe pas verifikimit të ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut përkatës, në përputhje me:

a) pikën 5 dhe pikën 6 të nenit 14 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar;

b) dhe nenin 7 të ligjit nr. 107/2016, të ndryshuar me ligjin nr. 36/2024, "Për prefektin e qarkut", i cili përcakton procedurën dhe kompetencën e prefektit për verifikimin e akteve me karakter normativ dhe efekte financiare të miratuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2. Nëse Prefekti nuk shprehet brenda afatit të përcaktuar me ligj për verifikimin e ligjshmërisë, akti konsiderohet i konfirmuar në heshtje dhe marrëveshja hyn automatikisht në fuqi.

Neni 12

Dispozitat e Fundit

1. Kryetarët e Bashkive caktojnë përfaqësuesin në Komitetin Koordinues për Punësim dhe koordinatorin brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes
2. Mbledhja e parë e Komitetit Koordinues për Punësim zhvillohet 15 ditë nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes dhe thirret nga përfaqësuesi i bashkisë me numër më të madh popullsie, pjesë e kësaj Marrëveshja. Në mbledhjen e parë konstituuese, Komiteti miraton planin e punës dhe kalendarin e takimeve.

Nënshkruar në datë /-----/ 2026

Për Bashkinë e Vlorës	**Për Bashkinë e Kamzës**
---	---
ZJ/Z.	**ZJ/Z**

Kryetari i Bashkisë

Për Bashkinë e Shkodrës

ZJ/Z
Kryetar i Bashkisë

Për Bashkinë e Tiranës

ZJ/Z
Kryetar i Bashkisë

Për Bashkinë e Sarandës

Zj/Z
Kryetar i Bashkisë

Kryetar i Bashkisë

Për Bashkinë e Dibrës

Zj/Z
Kryetar i Bashkisë

Për Bashkinë e Kukësit

Zj/Z
Kryetar i Bashkisë

Për Bashkinë e Himarës

Zj/Z.
Kryetar i Bashkisë